

## Vendim nr. 257 datë 08.11.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar

në datën 08.11.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 9 (B) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** BARDHYL IBRA

**OBJEKTI:** Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit brenda afatit të arsyeshëm të parashikuar të kësaj çështjeje me nr. 2873 Akti, datë 22.03.2016 të regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si dhe nr. 00337/2023 në Gjykatën tuaj të Lartë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, pikat 1 dhe 2 dhe 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, pika 1 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 399/2, shkronja “b”, 399/5, 399/6, shkronja “b” dhe 399/7 të ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”; nenet 318, 319 dhe 320 të Kodit të Procedurës Penale; nenet 48 dhe 60 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe mosmarrëveshjet administrative”; vendimet nr. 48, datë 03.07.2017; nr. 16, datë 16.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese; vendimi i Gjykatës së Strasburgut çështja Kola kundër Shqipërisë.

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Bardhyl Ibra në datën 26.11.2015 i ka paraqitur ankim Prokurorit të Përgjithshëm, duke kërkuar marrjen e masave disiplinore ndaj prokurorëve B.M., A.Xh., N.H., si dhe oficerëve të Policisë Gjyqësore K.O. dhe A.L. pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Ai ka pretenduar se këta prokurorë dhe oficerë të Policisë Gjyqësore kanë shpërdoruar detyrën në bashkëpunim, pasi e kanë arrestuar arbitrarisht dy herë radhazi, jashtë kushteve të flagrancës të parashikuar nga nenet 228/1, 251 e 252 të Kodit të Procedurës Penale (KPP-së) dhe vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 7 datë 14.10.2011, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 8737 datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe të disa urdhrave dhe udhëzimeve të prokurorëve të përgjithshëm ndër vite.

2. Me shkresën nr. 1582/2 prot., datë 16.03.2016, Prokuroria e Përgjithshme ka sqaruar kërkuesin: “Pas njohjes me pretendimet tuaja dhe pas verifikimit të tyre, kemi konstatuar se aktualisht procedimi penal Nr.2476/2014 po gjykohet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe bazuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, si dhe të praktikës së konsoliduar gjyqësore është kjo gjykatë që do të shqyrtojë dhe vlerësojë ligjshmërinë e veprimeve të kryera nga prokurorët B.M. dhe A.Xh. për këtë procedim penal. Lidhur me procedimin penal Nr. 2154/2015”[...]të gjitha pretendimet tuaja janë shqyrtuar nga Gjykata e Apelit Durrës [...] Të gjitha pretendimet që ju keni në lidhje me procedimin penal Nr.2476/2014 duhet t’i paraqitni përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan”.

3. Në datën 24.03.2016 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi, duke kërkuar nga gjykata të detyrojë palën e paditur, Prokurorin e Përgjithshëm dhe Këshillin e Prokurorisë pranë Prokurorisë së Përgjithshme, për të nisur inspektimin dhe marrjen e masave disiplinore për personat e interesuar.

4. Me vendimin nr. 1896, datë 20.04.2016, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur mungesën e juridiksionit gjyqësor administrativ për shqyrtimin e kësaj padie. Kjo gjykatë ka arsyetuar se ajo nuk mund të “detyrojë” Prokurorin e Përgjithshëm apo Këshillin e Prokurorisë të ushtrojnë kontrolle apo të marrin masa disiplinore ndaj prokurorëve apo oficerëve të Policisë Gjyqësore mbi bazën e ankesave të individëve edhe në rast se ato janë të bazuara. Këto veprime nuk mund të konsiderohen veprime administrative në kuptim të nenit 2 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative”, ndaj mbetet në diskrecionin e organit administrativ përcaktimi i sjelljes dhe kompetencës së tij në

raport me individët dhe personat juridikë. Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

5. Në datën 31.05.2016 kërkuesi ka paraqitur ankim të veçantë kundër vendimit nr. 1896, datë 20.04.2016 të kësaj gjykate, duke pretenduar se gjykata nuk ka përcaktuar se cilit juridiksion i përket çështja, ndërkohë që duhej të ishte shprehur që në nisje të procesit gjyqësor se nuk kishte kompetencë lëndore për gjykimin e çështjes.

6. Me vendimin e datës 26.07.2016, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur mospranimin e ankimit të veçantë të paraqitur nga kërkuesi Bardhyl Ibra ndaj vendimit nr. 1896 (80-2016-1901), datë 20.04.2016 të gjykatës administrative të shkallës së parë, me arsyetimin se është paraqitur jashtë afatit dhe se kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në gjykatën administrative të apelit, nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.

7. Me vendimin nr. 20 (86-2023-142), datë 08.02.2023, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të datës 27.07.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pranimin e ankimit të veçantë, duke arsyetuar se afati i ushtrimit të së drejtës për ankim të veçantë ndaj vendimit për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit fillon të nesërmen e njoftimit të vendimit të arsyetuar nga gjykata, për rrjedhojë në rastin konkret është respektuar ky afat 5-ditor nga rekursuesi/paditësi.

8. Me vendimin nr. 00-2024-878, datë 07.03.2024, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1896, datë 20.04.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pushimin e gjykimit të çështjes, duke arsyetuar se paditësi nuk gëzon legjitimitet formal procedural në ngritjen e padisë, për rrjedhojë gjykata duhej të vendoste pushimin e çështjes, si një padi që nuk mund të ngrihej.

9. Në datën 22.08.2024 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij.

10. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

## II

### Pretendimet e kërkuetit

11. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmblëdhur, ka pretenduar cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*, pasi kanë kaluar të gjitha afatet ligjore për shqyrtimin e kësaj çështjeje që nga data 23.03.2016, që është dorëzuar kërkesëpadi në shkallën e parë dhe

deri në datën 07.03.2024, që është gjykuar në Gjykatën e Lartë, pra kanë kaluar 7 vjet, 9 muaj dhe 14 ditë.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimimin e kërkuarit

12. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

13. Si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, kërkuari, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë.

14. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Në nenin 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, përmbushja e këtij kriteri është detajuar në dy hipoteza: i) kur kërkuari ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive përpara se t’i drejtohet Gjykatës; ii) kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete efektive në dispozicion.

15. Kërkuari ka pretenduar se ndaj tij është zhvilluar një proces tej afatit të arsyeshëm ligjor, pasi nga momenti që është dorëzuar kërkesëpadia në gjykatën e shkallës së parë dhe deri në datën 07.03.2024, që ka përfunduar shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë, kanë kaluar 7 vjet, 9 muaj dhe 14 ditë.

16. Në lidhje me pretendimin për zhvillimin e një procesi tej afatit të arsyeshëm, dispozitat e Kodi të Procedurës Civile (*KPC*), që kanë hyrë në fuqi në nëntor 2017,

parashikojnë mjetet juridike për t'u mbrojtur nga cenimi i së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm. Konkretisht, në këto dispozita përcaktohet kuptimi i afateve të arsyeshme (neni 399/2), mjetet e mbrojtjes nga cenimi, kërkesa për përsheptimin e gjykimit (neni 399/4), kërkesa për dëmshpërblim dhe kuptimi i shpërblimit të drejtë (neni 399/3), gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës (nenet 399/4 dhe 399/6), rregullat për gjykimin e kërkesës (neni 399/7), marrja e vendimit (neni 399/8) etj. Për rrjedhojë, ligji procedural ka parashikuar mjete juridike me qëllim që individit t'i garantohet mbrojtja efektive në lidhje me pretendimet për cenimin e së drejtës për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm.

17. Në rastin konkret, duke qenë se kërkuesi pretendon kohëzgjatje të paarsyeshme nga gjykatat, Kolegji vëren se nuk rezulton që ai t'u jetë drejtuar më parë atyre me kërkesë për konstatimin e gjykimit të çështjes tej afatit të arsyeshëm, sipas nenit 399/6, shkronja "c", të KPC-së.

18. Në rast se individi nuk i shteron mjetet juridike në momentin dhe kohën e duhur, në përputhje me mundësitë dhe të drejtat që i ofron legjislacioni i zakonshëm për korrigjimin e shkeljes së pretenduar dhe, për më tepër, nëse nuk provon se këto mjete janë joefektive, kjo nuk nënkupton se ai mund të rivendoset në të drejtën për të ngritur pretendime në Gjykatë në përfundim të të gjithë procesit gjyqësor, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, për arsyeshmërinë e kohëzgjatjes tërësore të procesit.

19. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja "a", të ligjit nr. 8577/2000.

20. Në kushtet kur kriteri paraprak për shterimin e mjeteve juridike efektive nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre. Prandaj, në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja "d", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.